

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtimi i Fiderit të Ri nr. 12/20 kV, N/ST Plasmas 110/20kV, Kabinave dhe rrjetit TU me kabëll ABC”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45231400-9 Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT: 199,839,204.93 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e katër pikë nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga te ardhurat e OSHEE Group Sh.a.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

"3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën"

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e perlllogaritur e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. (neni 43, pika 2, germa "b" VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar)

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "b", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

"3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën"

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore

dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja "b" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar (i ndryshuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009; me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 5.2.2010; me ligjin nr.10 297, datë 8.7.2010; ligjin nr. 47/2016, datë 28.4.2016; ligjin nr. 126/2024, datë 19.12.2024)

"Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii.ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël."

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht. (neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.
2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

➤ Konkretisht, për kontrata të realizuara me **ent publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) *Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojes ne DST per realizimin e punimeve*
- b) *Kontrate Sipërmarrje*
- c) *Situacionin përfundimtar*
- d) *Akt kolaudimi objekti*
- e) *Fature tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruar në organet tatimore*

➤ Konkretisht, për kontrata të realizuara me **sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) *Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojes ne DST per realizimin e punimeve*
- b) *Kontrate Sipërmarrje*
- c) *Situacionin përfundimtar*
- d) *Akt kolaudimi objekti*
- e) *Fature tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruar në organet tatimore*

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 - Liçenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N.P-1- A Punime gërmimi në tokë;
- N.P-4 -B Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.
- N.P-11- D Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N.S –18 – A Punime topogjeodezike.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

*Kur Operatori Ekonomik është i huaj ai duhet të paraqesë liçencën e ekuivalentuar me kategoritë e kërkuara.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korrespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.

Argumentimi: Licencat profesionale përputhen me natyrën, përmasat dhe vlerën e punimeve të objektit të kontratës. Keto licenca dëshmojnë aftësinë profesionale të shoqërisë për zbatimin me sukses të kontratës. Klasifikimi i kategorisë është kryer sipas vlerës së punimeve konkrete në projekt-preventiv. Kërkesa për këto licenca profesionale është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr.162 të datës 23.12.2020”Për Prokurimin publik”(I ndryshuar),neni 39,pika 6/a,të VKM nr.285 datë 19.05.2021”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), si dhe VKM nr.42 datë: 16.01.2008”Për miratimin e klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”(i ndryshuar).Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(i ndryshuar), neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të punimeve për këtë objekt.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P- 1	Punime gërmimi në tokë	Gërmim gropash shtyllash	A	0-20 milion lekë
N.P- 4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudha me kavo dhe pista aeroportuale	Shtresë asfaltobetoni me granil guri,kave 4cm, me makineri; prerje asfalti me disk në të dy anët, shtresa zhavori, stabilizant, çakëll, ngjeshje shtresash, punime rikthim rruge pas hapjes së kanalit.	B	21-50 milion lekë
N.P -11	Ndërtime për N/Stacione, kabinat e transformacionit, linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike	Punime ndërtimore-montuese: F.V shtylla te centrifuguara b/a,/F.V kabëll ajror ABC me vetembajtje + aksesor/F.V kabëll furnizimi abonentësh + aksesor/punime izolimi/punime-montimi: kabine: pajisjet TM/TU, transformatore, panele,tokezim.	D	101-200milion lekë
N.S -18	Punime topogjeodezike	Largimi i dherave dhe kthimi i sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, piketim shtyllash.	A	0-20 milion lekë

2.3.3 - Certifikatat e cilësisë që duhet të dorëzojnë operatorët:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent. (SSH EN ISO 9001:2015)
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent. (SSH EN ISO 14001:2015)
- Certifikatat e cilësisë sipas standartit SSH EN ISO 45001:2023 (Për sistemin e Menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent.

* Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DAP).

* Operatori ekonomik mund të paraqesë certifikatat e mësipërme sipas standarteve shqiptare mbi konformitetin e standartit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

* Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatat e mësipërme ISO, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje".

Argumentimi : Lidhur me kriterin e kërkuar si më sipër, komisioni i është referuar Ligjit Nr.10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" (i ndryshuar), Ligjit Nr.10237 Dt:18.2.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në punë", Ligjit Nr.162 datë:23.12.2020 "Për prokurimin publik" neni 77, dhe neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), ku nisur nga përcaktimi i kërkesave për kualifikim për Operatorin Ekonomik bazuar në aftësitë teknike dhe profesionale citon se: *"Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit."*

Njëkohësisht në përputhje me dispozitat e nenit 36 të ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për kualifikim për Operatorin Ekonomik që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor ku në pikën 3/b citohet se: *standarteve kombëtare që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standarteve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standartizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standarteve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.*

Komisioni vendosi të kërkojë çertifikatat e mësipërme për të vërtetuar që Operatori Ekonomik ka kapacitet organizativ dhe teknik dhe disponon licencat mbi menaxhimin e cilësisë së punimeve, i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Në këtë mënyrë komisioni gjatë hartimit të këtyre kriterëve siguron që kërkesat të jenë të hapura dhe nuk kufizon konkurrencën pa arsye objektive.

2.3.4 - Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Librezë pune (përkatëse)
- ii. CV (përkatëse)
- iii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (I ndryshuar) dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(I ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve.

Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

VKM Nr.42 datë:16.1.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”-kreu IV,pika 1/a dhe ligjit nr.8402 datë 10.9.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(I ndryshuar),neni 8 ku citohet:

Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore."

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.

Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane.

2.3.5- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Gjeomatik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve.

Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Në lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Për sa më sipër, është e nevojshme që Operatorët ekonomikë të pasqyrojnë referenca të përshtatshme nga kontratat të zbatuara në të shkuarën nga ana e tyre.

- Inxhinieri i Ndërtimit : në mënyrë të përgjithshme është përgjegjës për punimet civile që kanë të bëjnë me betonimet e shtyllave, bazamentet e kabinave, rikthimet e rrugëve, të linjave TM/TU në objekt, duke siguruar zbatimin e kushteve të sigurisë.
- Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Gjeomatik: në mënyrë të përgjithshme është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike që kanë të bëjnë me: piktetime në lidhje me pozicionimin e shtyllave të linjave TM/TU në terren, kontrollon lartësitë e kabllit, kordinatat e kabinave, azhornimin e gjurmës dhe kontrollon përputhjen e punimeve.
- Inxhinieri Elektrik : është përgjegjës për zbatimin e projektit të miratuar, sipas kushteve teknike për punime në linja dhe kabina elektrike përcaktuar sipas Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik.
- Inxhinieri i Mjedisit : është përgjegjës për punimet në objekt, për zbatimin dhe monitorimin e masave mjedisore, në menaxhimin e mbetjeve nga gërmimet, rikthimi i terrenit.

2.3.6 - Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 62 punonjës. Afati i punimeve duke gjykuar mbi natyrën dhe volumin e punimeve që do të kryhen do të jetë 300 ditë.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor për 3 muajt e fundit të vitit ushtrimor (aktual).
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të vitit ushtrimor (aktual).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve është kërkuar duke ju referuar përmasave dhe specifikës së Investimit që do të kryhet. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve është mbajtur në konsideratë natyra e punimeve, volumi i punimeve, zona gjeografike që mbulon ky investim i parashikuar, afati i kryerjes së tyre duke përfshirë këtu edhe numrin total të punonjësve (Inxhinierë, teknikë, elektrikist,

specialist, punonjës të kualifikuar, punëtorë të thjeshtë, punëtorët e mjeteve të rënda apo të thjeshta etj), e lidhur kjo me të vetmin qëllim të zbatimit të tij sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Duke u bazuar në preventivin e punimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse, është përcaktuar numri punonjësve që nevojitet për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë si më poshtë:

Total orë pune = 149690.99 (referuar orëve të punës për çdo zë pune të preventivit)

Orë /1 ditë pune = 8 orë

Total Ditë pune puntori= 149690.99 orë/8 orë = 18711.37 ditë pune

Sipas grafikut të punimeve: 50 javë * 6 ditë = 300 ditë pune

Numri i fuqisë punëtore= 18711.37/300 ditë = 62 punonjës

Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve si më sipër, komisioni gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria e tyre, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të liçensës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe referuar edhe volumeve të punimeve të parashikuar në preventivin dhe projektin përkatës dhe konkretisht:

- Inxhinieri i Ndërtimit : në mënyrë të përgjithshme është përgjegjës për punimet civile që kanë të bëjnë me betonimet e shtyllave,të linjave TM/TU në objekt,siguron zbatimin e kushteve të sigurisë.
- Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Gjeomatik: në mënyrë të përgjithshme është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike që kanë të bëjnë me: piketime në lidhje me pozicionimin e shtyllave të linjave TM/TU në terren.kontrollon lartësitë e kabllit , kordinatat e kabinave,azhornimin e gjurmës,kontrollon përputhjen e punimeve.
- Inxhinieri Elektrik : është përgjegjës për zbatimin e projektit të miratuar, sipas kushteve teknike për punime në linja dhe kabina elektrike përcaktuar sipas Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik.
- Inxhinieri i Mjedisit : në mënyrë të përgjithshme është përgjegjës për punimet në objekt, për zbatimin dhe monitorimin e masave mjedisore,në menaxhimin e mbetjeve nga gërmimet,rikthimi i terrenit.

Lidhur me disponueshmërinë e pjesës tjetër të stafit teknik që është kërkuar (teknik, elektrikist, specialist, punonjës të kualifikuar, punëtorë të thjeshtë, punëtorët e mjeteve të rënda apo të thjeshta), nevojitet prezenca e tyre në objekt pasi nisur nga zërat e punimeve që do të kryhen në objekt është një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës: Si Psh:2.37/5b-Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km / 4.176-Transport materiale elektrike me kamion me vinç-5-10 ton deri 20 km//3.722-Transport element betoni dhe b/a me auto deri 10 km/4.172-Transport shtylla b/a me krah deri ne 10 m/ etj...

- Teknikë/elektricist - janë të nevojshëm pasi bëjnë të mundur zbatimin e punimeve sipas projektit, zbatimin e masave të sigurisë elektrike në përputhje me rregulloren e punimeve në TM/TU, shkëputjen, izolimin dhe tokëzimin e pjesëve të tensionit gjatë punimeve, montimin e pajisjeve te ndryshme si: izolatorë, përçues, tirantuesa, aksesorë, montimin dhe lidhjen e kabllave TU, transformatorëve të fuqisë dhe pajisjeve ndihmëse, testime elektrike dhe kolaudime teknike si kryerjen e matjeve elektrike të tensionit, rrymës dhe izolimit pas përfundimit të punimeve.

- Punëtorët ndihmës – ndihmojnë në shtrirjen e kablllove, përgatitjen e vendit të punës dhe bartjen e materialeve.
- Vinçier – është i nevojshëm pasi ngarkon, transporton dhe vendos transformatorë, panele dhe elemente të rëndë të kabinës.
- Eskavatorist – është e nevojshme në fazën civile të punimeve pasi bën të mundur hapjen e kanaleve për vendosjen e kablllove, bën të mundur gërmimin e themeleve për shtyllat e betonit, mundëson ngarkim, shkarkimin e materialeve të rënda.
- Automakinist – është i nevojshëm sepse transporton materiale elektrike si (kablo, transformatorë, shtylla) nga magazina në objekt. Njëkohësisht transporton edhe materiale inerte dhe ndërtimore si (rërë, zhavor, beton) për punimet civile të kabinës. Gjithashtu shërben edhe për heqjen e materialeve të dëmtuara (gjatë fazës së prishjes ose gjatë fazës së rikonstruksionit).

Kriteri i mësipërm është në përputhje dhe në proporcion me volumin e kontratës si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuara, vlerën dhe natyrën e saj .

Njëkohësisht kriteri për stafin si më sipër, njëkohësisht lidhet ngushtësisht dhe është e diktuar edhe nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit dhe zërat e punimeve.

2.3.7- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 15 punonjës të specializuar/kualifikuar, të cilët duhet të jenë me statusin elektrikistë, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë, të pajisur me kontratë pune, dëshmi profesionale (diplomë, çertifikata trajnimi etj..) si dhe dëshmi kualifikimi të Sigurimit Teknik.

Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier" (i ndryshuar), operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo më pak se 62 copë
- Jelek sinjalizues – jo më pak se 62 copë
- Syze mbrojtëse – jo më pak se 62 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën – jo më pak se 8 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 3 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 30 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë rrugore – jo më pak se 30 copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi – jo më pak se 15 copë
- Kambaleca për ngjitjen në shtyllë - jo më pak se 15 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila – jo më pak se 6 copë

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- Numri i fuqisë punëtore u llogarit duke u bazuar në volumin e punimeve që duhen kryer sipas projekt-preventivit dhe afatit 300 ditë për kryerjen e punimeve. Në bazë të orëve të punës të marra nga analizat për secilin zë, të zonës gjeografike, të natyrës së punimeve, volumit të punimeve, afatit të parashikuar, u llogarit shifra prej 62 punonjës.
- Komisioni vlerëson se të paktën 15 punonjës duhet të jenë pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektorati Qendror Teknik ose nga organi kompetent në bazë të ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001”Për garantimin e Sigurisë së punës së pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” (te ndryshuar) dhe ligjit Nr.13/2013, datë 14.02.2013, të cilët të jenë elektriciist dhe me dëshminë përkatëse të formimit.
Këto dëshmi duhet të kërkohen për shkak të natyrës së punimeve, punonjësit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë për caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojnë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.
- Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë : 1 (një) Inxhinier Elektrik ,1 (një) Inxhinier Ndërtimi,1 (një) Inxhinier Mjedisi, 1 (një) Inxhinier Gjeodet,1 topograf që të mbikëqyrin punimet në fazën e zbatimit. Këta inxhinier kanë lidhje edhe me liçencat profesionale që duhen për zbatimin e projektit.
- Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.
- Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.8 - Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga të cilët 3 (tre) automakinist dhe 2 (dy) eskavatorist.

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë në rast se mjetet e punës (makineritë) janë në pronësi të operatorit.

Në rastet kur makineritë disponohen me qira, nuk është e nevojshme që manovratorët e mjeteve të figurojnë në listpagesat e shoqërisë. Në këtë rast ata duhet të kenë të vlefshme vetëm kontratën e punës dhe dëshmitë e drejtimit.

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues ,kapaciteti mbajtës minimum 5 (pesë) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton.	2 copë	Pronësi ose me qira
Autovinç 16-20 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Betoniere 500l	2 copë	Pronësi ose me qira
Vibrator(rul vibrues)	2 copë	Pronësi ose me qira
Eskavator me goma 0.25 m ³	2 copë	Pronësi ose me qira
Moto Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qira
Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kablllove	2 copë	Pronësi ose me qira
Kenotron për kablllo	1 copë	Pronësi ose me qira
Makineri për prerje asfalti	1 copë	Pronësi ose me qira
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qira
Megaohmetër 2500V	1 copë	Pronësi ose me qira
Terraometër për matjen e rezistencës së tokëzimit	1 copë	Pronësi ose me qira
Frezë asfalti	1 copë	Pronësi ose me qira
Set karukulla per shtrirjen dhe tërheqjen e kablllove për pozicione horizontale dhe per kthesa 90 gradë	30 copë	Pronësi ose me qira
Fadromë	2 copë	Pronësi ose me qira
Autobetoniere	1 copë	Pronesi ose me qira
Set sinjalistike për punime në rrugë	2 sete	Pronësi ose me qira
Karrel sinjalizues për punime në rrugë	1 copë	Pronesi ose me qira
Kuti komplet veglash pune	2 sete	Pronësi ose me qira
Damper kantieri	2 copë	Pronesi ose me qira

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë*

dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

Mjetet duhet të kenë të gjithë dokumentacionin e vlefshëm teknik dhe ligjor për punë/levizje. Për mjetet e përmendura më sipër, drejtuesit e tyre të kenë leje drejtimi përkatëse.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për realizimin e të gjitha punimeve brenda standarteve teknike,nevojitet që Operatorët Ekonomik të kenë në dispozicion kapacitet te mjaftueshëm edhe të mjeteve dhe pajisjeve teknike si :makineri gjermimi për realizimin e kanaleve dhe themeleve;mjete transporti për materialet dhe mbetjet e punimeve;pajisje ngritëse për vendosjen e kabinave dhe pajisjet elektrike;pajisje për shtrirjen e kablllove TM;pajisje për ngjeshjen e shtresave pas rikthimit të kanaleve;pajisje dhe vegla profesionale për montime elektrike TM/TU;pajisje matëse dhe testuese për kabllot dhe sistemet e tokëzimit etj,me qëllimin e vetëm të përmbushjes së kontratës.

Pasi duke qenë se investimi do të kryhet në një zonë fushore,duke parë volumet e punimeve,afatin për realizimin e saj,vlerën e kontratës,qëllimi i autoritetit kontraktor është që zbatimi i punimeve të kryhet në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike duke garantuar këtë të fundit për cilësinë e punimeve dhe qëndrueshmërinë e saj,gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Për këtë arsye është e nevojshme që Operatorët Ekonomik duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit.

Kërkesat për këto mjete lidhen drejtpërdrejtë me natyrën dhe kompleksitetin e objektit, pasi punimet përfshijnë ndërhyrje në rrjetin elektrik 20kV, punime pranë infrastrukturës ekzistuese dhe kërkojnë garantimin e sigurisë teknike, cilësisë së zbatimit dhe realizimin brenda afateve të caktuara.

Përcaktimi i këtyre mjeteve është bërë në mënyrë proporcionale me volumin dhe karakteristikat teknike të objektit duke synuar që Operatori Ekonomik të ketë kapacitetet për realizimin e punimeve të parashikuara.

Në bazë të punimeve që do të kryhen, nisur nga preventivi komisioni ka vlerësuar se mjetet e kërkuara janë të domosdoshme për përmbushjen e kontratës si më poshtë:

- Kamion vetëshkarkues, kapaciteti mbajtës minimum 5 (pesë) ton dhe maksimumi 10 (dhjetë) ton – është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e dherave në objekt si dhe për mbushjen e kanaleve ose për mbushjen dhe mbrojtjen e kablllove. Kjo sjell një efikasitet dhe shpejtësi pasi lejon një zhvendosje të shpejtë të materialit, përdoret në terrene të vështira si në rastin konkret ku në disa zona terreni rezulton të jetë kodrinor. Zëri në analizë: 4.176-Transport materiale elektrike me kamion me vinc 5-10 ton deri 20 km.
- Autovinç 16-20 ton – është e nevojshme pasi shërben për ngritjen dhe montimin e shtyllave, të transformatorëve të kabinave elektrike të transformacionit-parafabrikat-Box prej betoni në pozicionin e projektuar dhe siguron vendosje të saktë mbi bazament pa demtuar elementët e kabinës. Zëri në analizë: An.An-M-K-1:F.V shtylla të centrifuguara B/A cent.10/6m/kN,150/300 d1/d2(me makineri) / An.An-M-K-1:F.V shtylla të centrifuguara B/A cent.9/15m/kN,220/355-d1/d2(me makineri) /An.An-M-K-1:F.V shtylla të centrifuguara B/A cent.10/15m/kN,220/370-d1/d2(me makineri)/4.04-M:Montim transformatorë të fuqisë ÷560 kVA 20/10/6/0.4kV/4.05-M-Montim”Box”parafabrikat(2l+1t)-kabinë parafabrikat ,bazament kabine, set pajisjesh TM/TU,tokëzimi i brendshëm,ndriçimi pa transformatorin e fuqisë.
- Betoniere 500l – është e domosdoshme për punimet e betonit për bazamentet e shtyllave, kabinave, kanaleve të kablllove. Zëri në analizë: 3.243-Struktura monolite betoni C 16/20.
- Vibrator – është e domosdoshme për ngjeshjen dhe kompaktimin e betonit për bazamentet që të mos krijohen boshllëqe. Bën të mundur ngjeshjen e shtresave pas vendosjes së kabllit:rërë,zhavorr, stabilizant, shtresa rrugore.
- Eskavator me goma 0.25 m³ - është i nevojshëm për hapje kanalesh për kablllo, themele për shtylla, gropa për bazamente/për pastrim ose rrafshim terreni. Njëkohësisht shërben edhe për ngarkim+shkarkim të materialeve (zhavorr, rërë, dhe). Zëri në analizë: 3.498/b:Gërmim dheu për gropa shtyllash, T/L, në tokë të fortë kat.IV, ~2.5m, sip.tabani 1.5 m².
- Moto Gjenerator – nevojitet pasi shërben për furnizimin me energji të pajisjeve elektrike ose për testimet në terren të pajisjeve.
- Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kablllove – një mjet mbajtës i domosdoshëm që mundëson shtrirjen e sigurt dhe të rregullt të kablllove nga barabani. Kjo sjell lehtësim në tërheqjen e kabllit nga barabani pa e demtuar atë, pasi barabani qëndron i ngritur dhe rrotullohet lirshëm mbi kambalec.

- Kenotron për kabllot – është e nevojshme pasi është një pajisje e cila teston izolimin e kabllave(kontroll i cilësisë para vendosjes së tij në objekt).
- Makineri për prerje asfalti – është e nevojshme pasi është një pajisje e cila bën të mundur prerjen e asfaltit në vijën e caktuar pas hapjes së kanalit.Siguron prerje të rregullt dhe rikthim cilësor të rrugës.
- Mini eskavator – është e nevojshme pasi është një pajisje e cila kryen gërmime për kanalet e kabllave TM dhe TU.Ka një përdorim në zona pranë kabinave,trotuareve,rrugëve ekzistuese dhe lejon punime më preçize pa dëmtuar infrastrukturën ekzistuese.
- Megaohmetër 2500V – është e nevojshme pasi është një pajisje e cila mat rezistencën e izolimit të kabllave dhe qarqeve elektrike.Jep mundësinë dhe zbulon probleme të mundshme të izolimit para furnizimit me energji elektrike.
- Terraometër për matjen e rezistencës së tokëzimit – është e nevojshme pasi është një pajisje e cila mat cilësinë e sistemit të tokëzimit.Kontrollon rezistencën e elektrodave,shiritit të tokëzimit.Eshtë i nevojshëm në kabinat 20kV-për sigurinë e personelit dhe të pajisjeve.
- Set karukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e kabllave për pozicione horizontale dhe për kthesa 90 gradë – është e nevojshme pasi është një pajisje e cila mbështet dhe drejton kabllot gjatë shtrirjes në kanal.Mbron izolimin e kabllit nga dëmtimet mekanike.Siguron kthesa të kontrolluara sipas rrezes minimale të perkuljes së kabllit.
- Fadromë – është e nevojshme pasi është një pajisje që kryen punime më voluminoze si:hapje kanalesh,ngarkim të dheut të dalë nga gërmimi, shpërndarje materiali mbushës.
- Damper kantieri- është i nevojshëm për transportuar dhe, rërë, zhavorr, gurë dhe materiale të tjera ndërtimi, larguar mbeturinat e gërmimeve. Per te lëvizur materiale nga një pjesë e kantierit në tjetrën me shpejtësi dhe efikasitet dhe e bere me te thjeshte falë karrocere qe ngrihet dhe anohet.
- Set sinjalistike për punime në rrugë–është e nevojshme pasi siguron organizimin dhe mbrojtjen e kantierit në rrugë:tabela paralajmëruese/ konet/ barriera/elemente orientues.Eshtë shumë i rëndësishëm nga pikëpamja e sigurisë për punimet përgjatë rrugës nacionale.
- Autobetoniere: është e nevojshme për transportimin e betonit të gatshëm nga impianti i prodhimit në kantier. Eshte e nevojshme pasi punimet që do të kryhen përgjat rrugës nacionale, krijon një hapsirë të kufizuar pune, pasi në këto segmente nuk ka mundësi praktike për përgatitjen e betonit me betoniere 5001, si mungesë hapsire, ndikimi ne qarkullim. Prezenca e ketij mjeti siguron furnizimin me beton të gatshëm në objekt, me cilësi të kontrolluar sipas nevojave të punimit të betonimit.
- Karrel sinjalizues për punime në rrugë – është e nevojshme pasi jep paralajmërim vizual për automjetet që afrohen në zonën e punimeve dhe përdoret për sigurinë e punëtorëve dhe përdoruesve të rrugës.

- Kuti komplet vegla pune – është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë komplet veglash profesionale për punime elektrike TM/TU (set çelësash mekanike; komplete kaçavidash të izoluar; pinca të izoluar: pinca prerëse kablli, shtrënguese, universale; thikë për zhveshje kabllorësh, prerëse kabllorësh TM/TU; mjete për heqje të izolimit të kabllorëve; çekiç; darë, sharrë dore, metër, mjete matese dore) për montimin e kabllorëve 20kV, terminaleve (pajisje për përpunimin e kokave të kabllit, vegla për montim terminalesh TM, çelësa momenti për shtrëngime sipas specifikimeve, pajisje për kontroll të fazimit, identifikim të kabllit), pajisjeve të kabinave dhe lidhjeve TU (çelësa momenti, vegla për lidhje të përçuesave të tokëzimit)- Pajisje sigurie për punime elektrike (doreza dielektrike sipas klasës së tensionit, tapet izolues dielektrik).

- Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

1-Analizat e çmimeve të zërave të preventivit janë marrë në bazë të VKM nr. 216 datë 13.04.2023”Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

2 – Analizat teknike që nuk janë në VKM Nr.216 datë 13.04.2023, janë hartuar si zëra jashtë liste bazuar në librin Nr.6 "Montimi i linjave dhe N/Stacioneve elektrike"si edhe në librin e “Manula preventivimi për rrjetat elektrike komunale “.

3 - Çmimet e bazës materiale janë marrë në bazë të manualit të SAP-it-OSHEE,studimit të tregut,bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;ose çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë OSSH sh.a.

4 - Volumet e gërmimeve, betonimeve dhe të montimeve janë marrë sipas standarteve të OSSH Sh.a bashkëngjitur projektit.

5 - Paga orare është marrë 484.90 lekë .

6 - Për punimet e montimit që nuk janë në manual i referohemi Udhëzimit nr.2 datë 08.05.2003”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

7 - Shpenzimet plotësuese janë marrë 8 % sipas VKM nr. 216 datë 13.04.2023, botuar në fletoren zyrtare nr.66 datë 19.04.2023.

8 - Norma e fitimit është marrë 10 % sipas VKM nr. 216 datë 13.04.2023,botuar në fletoren zyrtare nr.66 datë 19.04.2023.

Numri dhe lloji i makinerve, pajisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike.

Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative.

Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.9 - Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë:

- Liçensë të shoqërisë të lëshuar nga QKL, "Kodi III.2.B"- "Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve jo të rrezikshme" të vlefshme për mbetjet inerte/materiale të dala nga punimet e ndërtimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) liçenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

- Liçensë të shoqërisë lëshuar nga QKL, "Kodi III.2.B". "Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve jo të rrezikshme".

Duke qenë se objekti i prokurimit ka në përbërjen e tij punime civile të lidhura me realizimin e linjës TM 20kV kabllore nëntokësore, ndërtimin e kabinave Box 20kV dhe punime shoqëruese, referuar preventivit të punimeve parashikohet kryerja e punimeve të gërmimit të kanaleve, largimit dhe transportimit të materialeve të dala nga gërmimet si dhe menaxhimi i materialeve inerte të krijuara gjatë procesit të zbatimit.

Gjatë zbatimit të punimeve do të krijohen materiale të dala nga gërmimet dhe punimet civile (dhera, materiale inerte dhe mbetje jo të rrezikshme), të cilat duhet të grumbullohen, transportohen dhe menaxhohen në përputhje me kërkesat e legjisllacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

Për këtë arsye, komisioni vlerëson se është e arsyeshme që Operatori Ekonomik të disponojë Liçensë të shoqërisë të lëshuar nga QKL, "Kodi III.2.B"- "Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve jo të rrezikshme" të vlefshme për mbetjet inerte/materiale të dala nga punimet e ndërtimit, si dëshmi

e kapacitetit profesional dhe ligjor për realizimin e këtyre proceseve që janë pjesë përbërëse e objektit të kontratës. Ky kriter vendoset në përputhje me natyrën dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv; nevojën për menaxhimin e materialeve të dala nga gërmimet; kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve.

Duke ju referuar preventivit të punimeve, kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (zëri në analizë: 3.89/a-Gërmim dheu me eskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet/zëri në analizë: 3.88/a- Gërmim dheu me eskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk në tokë), dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit Nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë liçencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, komisioni gjykon se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Liçencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “ Për Liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ”, parashikohet se “ Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër, konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventiviti, kërkesa e autoritetit kontraktor për licencim është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, pasi krahas punimeve të gërmimit, operatori ekonomik fitues i kontratës duhet të kryejë edhe transportin e mbetjeve urbane, transportin e dherave dhe inerteve, i cili referuar kuadrin ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara .

2.3.10 - Për Listën e mëposhtme të artikujve :

- Elektroda tokëzimi / Aksesor
- Shtylla betonarme të centrifuguara 10/15m/kN,220/370,d1/d2
- Shtylla betonarme të centrifuguara 10/6m/kN,150/300,d1/d2
- Shtylla betonarme të centrifuguara 9/15m/kN,220/355,d1/d2
- Kabëll fuqie TU 0.6/1kV-XLPE-Al(në tokë/në shtyllë)
- Kabëll fuqie 20KV-Al unipolar(flat) iz.XLPE (1x185)mm²
- Litar Al/Celik (ACSR) 50mm²

- Terminale 20KV me kapikorda Al-Cu-seksion(70-120 mm²)-unipolar-amb.brendshëm/jashtëm
- Kabinë Box-parafabrikat (2I+1t)(baz.kabine,set pajisjesh TM/TU,tokëzim i brendshëm,ndriçim,urat TM/TU)
- Transformator fuqie 250/20/0.4kV
- Transformator fuqie 400/20/0.4kV
- Ndarës TM 3p-TM-20kV-630A-20kA-jashtëm
- Terminal TU 0.6/1kV në shtyllë për kalim nga kabli PVC në ABC(25-120mm²)
- Muftë unipolare TM 24kV për kabëll të thatë Al XLPE 1x(95-240mm²)
- Shkarkues TM 20kV,10kA- mbështetës kl1
- Shkarkues TM jashtëm ventil 6/10/20 kV

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- *Operatori ekonomik në rastin kur nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, fax, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike ose ekuivalenti i tij/saj) nga të cilat specifikimet teknike të produkteve të kërkuara të jenë në gjuhën e ofertës.Në rastet kur marrëveshjet janë në gjuhë të huaj,duhet të bëhet përkthimi në gjuhën shqipe dhe noterizimi i tij.*
- *Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve(skodat teknike) të prodhuesit për listën e artikujve si më sipër,në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.*
- *Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera,të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara(Test raportet për listën e mësipërme të artikujve,nëse rezultojnë në gjuhë të huaj,duhet të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen-kjo sipas VKM Nr.285 datë:19.5.2021”Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”.*

Argumentimi: 1. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar). Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së mallit të sipercituar.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte.

Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, e-mail-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktojë me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

2. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

- Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave.
Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.
- Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.
- Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.
- Gjithashtu kriteri për përkthimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e blerësit. Përkthimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mallrave. Kjo

ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

3. Kjo kërkesë në lidhje me testimet zyrtare është në përputhje me pikën 6/c, të nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

- Së pari, paraqitja e dëshmimeve të testeve zyrtare siguron një burim të besueshëm të informacionit për cilësinë e mallrave. Testimet zyrtare janë kryer nga institucione të pavarura dhe të autorizuar ose nga prodhuesi i vetë mallrave, duke garantuar pavarësinë dhe besueshmërinë e rezultateve. Ky informacion është i rëndësishëm për AK për të siguruar që mallrat janë të pajtueshme me specifikimet dhe standardet e kërkuara.
- Së dyti, kriteri për dëshmitë e testeve zyrtare ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve. Duke përdorur informacionin e testeve zyrtare, AK mund të identifikojë përparësitë dhe mangësitë e çdo oferte potenciale. Duke kërkuar paraqitjen e dëshmimeve të testeve zyrtare, AK mund të sigurojë që të gjithë operatorët ekonomikë kanë një mundësi të barabartë për të demonstruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të tyre. Kjo nxit konkurrencën e drejtë dhe siguron që oferta më cilësore të fitojë kontratën.

2.3.11 - Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 Specialist që të disponojë Certifikatë si:”Pergjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në punë”.

Argumentimi: Në bazë të VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”(i ndryshuar), në dispozitën III-pika 10.5 / 10.12 / 10.13 /dispozita IV-pika 7-a,b,b1,b2,b3,c1- shprehet qartësisht aftësitë që duhet të ketë punonjësi i ngarkuar për menaxhimin e riskut i cili duhet të plotësojë kushtet në lidhje me çështjet e sigurisë në punë.

Gjithashtu në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”(ndryshuar) dhe VKM Nr.312 Dt:5.5.2010 për : Miratimin e rregullores”Për sigurinë në Kantier”(i ndryshuar).

Vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që operatori ekonomik ,në këtë mënyrë lidhur me masat tekniko-organizative që do të ndërmerren, do të shmangë edhe rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë zbatimit të punimeve dhe do të realizojë ato sipas standarteve ligjore në fuqi.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga OSSH sh.a Drejtoria Qëndrore, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punimet objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Keto specifikime janë të unifikuara për të gjitha institucionet e varesise të OSHEE GROUP SH.A

Kerkesat e parashikuara në specifikimet teknike “Kërkesa të Detyrueshme” janë për mallrat të cilat do të vendosen në linjat elektrike që po prokurohen.

Keto kërkesa nuk plotësohen nga OE në momentin e hapjes së ofertave, por në momentin e zbatimit të punimeve dhe janë dokumenta që shoqërojnë materialet elektrike në momentin e zbatimit të kontrates, të cilat kontrollohen gjatë kohës së zbatimit, nga mbikqyresi i punimeve etj.

Termi “gjithë test raportet e fabrikes” nënkupton “test raportet e fabrikes” për të gjitha mallrat që do të vendosen në linjat elektrike, për të cilat është kërkuar një gjë e tillë.

Ditën e hapjes së ofertave OE me qëllim marrjen pjesë në procedurën e prokurimit do të referohen kërkesave të parashikuara në DST-te.

- Standartet e përdorura në specifikimet teknike janë konform kërkesave të standarteve të përmendura SSH, IEC, EN, DIN ose çdo standart tjetër ekuivalent me to.

Sqarim: Çdo kriter i parashikuar në nenin 26, pikë 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) dhe në shtojcën nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, përmbushet nga Operatorët Ekonomikë nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve.

Në bazë të nenit 26, pikë 6, i VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.”.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomik, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të

përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. (neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT